



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Nr. 7184 Prot.

Datë 15.06.2022

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.60, dt.15.06.2022

Mbi disa masa administrative dhe procedurale për delegimin e fashikujve të çështjeve penale për veprime verifikuese/hetimore/procedurale nga prokurorët tek oficerët e policisë gjyqësore

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ligjin nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” i ndryshuar, Udhëzimin nr.2, dt.29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, infomimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë

21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan,

Me qëllim :

- *Disiplinimin e rregullave dhe afateve të marrjes së fashikujve për veprime verifikuese/hetimore/procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore ;*
- *Përcaktimin e rregullave të sakta dhe afateve të qarta për marrjen dhe dorëzimin e këtyre fashikujve nga prokurorët dhe oficerët ;*
- *Forcimin e rregullshmërisë dhe qartësimin e përgjegjësisë për marrjen dhe dorëzimin e fashikujve nga oficerët e policisë gjyqësore ;*
- *Evidentimin e personit përgjegjës në rast situatë problematike ;*
- *Kontrollin dhe forcimin e rregullshmërisë në respektimin e afateve të vendosura nga prokurorët e cështjeve në urdhërat e kryerjes së veprimeve verifikuese/hetimore ose delegimin e veprimeve/kompetencave procedurale, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve dhe seksionit.*
- *Kontrollin e zbatimit të afatit të arsyeshëm si pjesë e procesin të rregullt ligjor të garantuar kushtetushmërisht.*
- *Konsolidimin e dilijencës në hetime nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.*

KONSTATOJ :

Drejtuesi i Prokurorisë në vijim të ushtrimit të kompetencave të tij ligjore ka konstatuar në shumë raste parregullsi dhe mungesë kujdesi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore për sa i takon evidentimit të saktë të momentit kohor në të cilin një fashikull i ka kaluar një oficeri të policisë gjyqësore për veprime verifikuese ose hetimore, si dhe të momentit kur fashikulli është kthyer së bashku me relacionin përfundimtar nga oficeri i policisë gjyqësore.

Në disa raste, rezulton se oficerët kanë marrë nga prokurorët e cështjeve për të kryer veprime verifikuese/hetimore si dhe aktet e materialeve penale, në një datë shumë të mëvonshme sesa data që mban akti përkatës delegues apo shkresa përcjellëse.

Po ashtu, rezulton në raste të tjera se oficerët e policisë gjyqësore kanë dorëzuar fashikujt e materialeve penale që kanë pasur në verifikim/hetim, së bashku me relacionet përfundimtare, por nuk kanë dokumentuar datën e saktë të dorëzimit të këtyre materialeve.

Nga ana tjetër, konstatohet në rastet kur situata parashtron një problematikë të caktuar, se ka vështirësi në ndarjen e qartë të personit përgjegjës që ka sjellë pasojën e caktuar në zvarritjen e hetimeve, shkeljen e afateve ligjore të hetimit dhe/ose paraburgimit etj, apo cënimin e të drejtave të ligjshme të palëve në proces.

Në këto rrethana, është e nevojshme të normohet momenti kohor i marrjes së një materiali për veprime hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore si dhe momenti kohor kur oficeri i policisë gjyqësore depoziton relacionin dhe aktet në përfundim të veprimeve të urdhëruara apo deleguara.

Në këtë mënyrë, jo vetëm që garantohet diligenca në hetime dhe sigurohet procesi i rregullt ligjor duke forcuar rregullat administrative dhe procedurale të delegimit apo urdhërimit të veprimeve hetimore ose procedurale por edhe do të jetë më e lehtë ndarja dhe evidentimi i personit përgjegjës në rast problematike me verifikimin/hetimin e një çështje penale.

UDHËZOJ :

1. Prokurorët kujdesen që të dorëzojnë fizikisht tek oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve dhe seksioneve, si rregull në të njëjtën datë që përmban urdhëri për kryerjen e veprimeve hetimore ose verifikuese si dhe urdhëri për delegimin e veprimeve procedurale/kompetencave, urdhërat në fjalë dhe aktet e materialeve penale që i'u përkasin këtyre urdhërave.
2. Si rregull, akti që urdhëron kryerjen e veprimeve të caktuara verifikuese ose hetimore si dhe akti që delegon kompetenca apo kryerjen e veprimeve të caktuara procedurale, të cilat i dorëzohen oficeri për veprim dhe ndjekje, paraqiten në formë të shkruar.
3. Oficerët e policisë gjyqësore kanë detyrim që të depozitojnë tek prokurorët e çështjeve, si rregull në të njëjtën datë që përmban

relacioni përfundimtar apo relacioni mbi ecurinë e veprimeve hetimore, relacionin në fjalë dhe aktet hetimore bashkëlidhur tij.

4. Kur urdhëri për kryerjen e veprimeve hetimore ose verifikuese si dhe urdhëri për delegimin e veprimeve procedurale/kompetencave, dhe materialet penale bashkëlidhur tyre, i'u dërgohen oficerëve të policisë gjyqësore pranë shërbimeve të policisë gjyqësore, si rregull protokollohen në regjistrin e protokollit dalës të prokurorisë dhe regjistrohen në regjistrin e protokollit hyrës të shërbimit të policisë gjyqësore. Shkresa përcjellëse që dokumenton këtë fakt i dorëzohet prokurorit të çështjes.
5. Kur për shkak urgjence urdhëri për kryerjen e veprimeve hetimore ose verifikuese si dhe urdhëri për delegimin e veprimeve procedurale/kompetencave, dhe materialet penale bashkëlidhur tyre, i'u dorëzohen dorazi oficerëve të policisë gjyqësore pranë shërbimeve të policisë gjyqësore, në fund të urdhërit përkatës oficeri i policisë gjyqësore i deleguar shënon datën dhe orën e marrjes së materialeve, fakt ky që konfirmohet me nënshkrim po aty nga oficeri dhe prokurori i çështjes si dorëzues.
6. Titullarët e institucioneve që kanë në varësi shërbime të policisë gjyqësore, pranë së cilave nga prokurorët dërgohen çështje për verifikimi apo hetim, kanë detyrimin që të marrin të gjitha masat e nevojshme administrative dhe të tregojnë të gjithë kujdesin e duhur, që urdhëri përkatës delegues dhe materialet bashkëlidhur tij, të kalojnë tek oficeri i deleguar apo urdhëruar nga prokurori i çështjes, menjëherë dhe gjithësesi brenda të njëjtës ditë të administrimit të materialeve prej institucionit.
7. Prokurorët e kësaj prokurorie dorëzojnë drejtpërdrejtë tek oficeri i policisë gjyqësore i Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, aktin delegues si dhe materialet e çështjes penale që i ngarkohet për verifikim apo hetim.
8. Oficeri i policisë gjyqësore i Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i deleguar

- apo urdhëruar për veprime, mënjëherë pas përfundimit të veprimeve të urdhëruara apo deleguara apo në përfundim të afatit të kryerjes së veprimeve verifikuese/hetimore/procedurale dorëzon drejtpërdrejtë tek prokurori i çështjes relacionin e çështjes në fjalë si dhe materialet e çështjes penale që ka pasur për verifikim apo hetim.
9. Oficeri i policisë gjyqësore i shërbimeve të policisë gjyqësore, i deleguar apo urdhëruar për veprime, mënjëherë pas përfundimit të veprimeve të urdhëruara apo deleguara apo në përfundim të afatit të kryerjes së veprimeve verifikuese/hetimore/procedurale dërgon si rregull me shkresë përcjellëse të protokolluar relacionin e çështjes në fjalë si dhe materialet e çështjes penale që ka pasur për verifikim apo hetim. Shkresa përcjellëse protokollohet në regjistrin e protokollit dalës të institucionit që përmban shërbimin e policisë gjyqësore dhe më pas regjistrohet në regjistrin e protokollit hyrës të prokurorisë. Nga Zyra e Sekretarisë së kësaj prokurorie, aktet kalojnë menjëherë dhe drejtpërdrejtë tek prokurori i çështjes.
 10. Oficerët e policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan në momentin që marrin në ngarkim për veprime verifikuese, hetimore ose procedurale materialet e një çështje penale, shënojnë në fund të urdhërit delegates datën e marrjes së materialit, fakt ky që konfirmohet kundrejt nënshkrimit po aty nga oficeri i deleguar dhe prokurori i çështjes.
 11. Në momentin që oficeri i policisë gjyqësore i seksionit apo shërbimeve, përfundon veprimet verifikuese, hetimore ose procedurale të urdhëruara apo deleguara, përpilon relacionin përfundimtar mbi faktet, provat dhe mënyrën e përfundimit të hetimeve. Këtë relacion, së bashku me aktet e çështjes në fjalë, e dorëzon sipas rregullave të këtij udhëzimi, si rregull brenda të njëjtës ditë, pranë prokurorit të çështjes.
 12. Kur përfundon afati i kryerjes së veprimeve verifikuese, hetimore ose procedurale, i caktuar nga prokurori i çështjes në aktin përkatës të delegimit dhe nga ana e oficerit nuk janë përfunduar të gjitha veprimet e urdhëruara apo deleguara, oficeri i policisë gjyqësore i shërbimeve

apo seksioneve, dorëzon tek prokurori i çështjes sipas rregullave të këtij udhëzimi një relacion mbi ecurinë e veprimeve verifikuese/hetimore/procedurale të kryera, ato të moskryera, shkaqet e moskryerjes si dhe pas diskutimit me prokurorin e çështjes mund të kërkojë zgjatje të afatit të përfundimit të veprimeve të urdhëruara apo deleguara. Prokurori i çështjes disponon me një urdhër të ri ose bën shënimin në urdhërin ekzistues nëse pranon apo refuzon kërkesën për zgjatje të afatit të kryerjes së veprimeve.

13. Oficeri i policisë gjyqësore i seksionit apo oficeri i shërbimeve të policisë gjyqësore në raste të ngutshme dhe urgjence, kur dorëzojnë dorazi relacionet dhe aktet e materialeve penale në prokurori, veprojnë në këtë mënyrë : prokurori i çështjes që merr relacionin dhe materialet bashkëlidhur tij, shkruan datën e marrjes në pjesën përfundimtare të relacionit, fakt ky që konfirmohet po aty kundrejt nënshkrimit nga prokurori i çështjes si marrës dhe oficeri si dorëzues i materialeve.
14. Për çdo situatë kur për arsye të ndryshme nuk gjejnë zbatim rregullat e mësipërm, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve, kanë detyrimin të dokumentojnë marrjen dhe dorëzimin e akteve procedurale të sipërcituara, nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e e-mail zyrtar. Në një situatë të tillë, teksti i komunikimit elektronik, printohet dhe bëhet pjesë e fashikullit të çështjes penale.
15. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve janë përgjegjës për zbatimin e disponimeve të këtij udhëzimi.
16. Çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me sa më sipër përbën shkak për përgjegjësi sipas ligjit.
17. Ngarkohet Zv.Drejtuasi i Prokurorisë për të ndjekur zbatimin e përcaktimeve të këtij udhëzimi dhe detyrimeve të tjera ligjore dhe nënligjore nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve. Në çdo rast Zv.Drejtuasi i Prokurorisë informon me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë për problematikat e hasura.

18. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve kanë detyrimin të njoftojnë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë në rast se konstatojnë moszbatim të disponimeve të këtij udhëzimi.
19. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët, oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan dhe pranë shërbimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe Komisaritet e Policisë Elbasan, Gramsh, Peqin, Cërrik, Librazhd si dhe pranë të gjitha shërbimeve të policisë gjyqësore në institucione të tjera. Një kopje e këtij udhëzimi i 'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti IT me kryerjen e njoftimit.
20. Një kopje e këtij urdhëzimi i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme për publikim në web në zbatim të nenit 46/5 të ligjit nr.97/2016.
21. Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 16.06.2022.

DREJTUES I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI

